



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.30

Prishtinë, më 20.10.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N 302

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Srdjan Popović, Shpejtim Bulliqi dhe Mufera Sinik.

Munguan: Bekim Haxhiu, Ismajl Kurteshi, Teuta Haxhiu dhe Shukrije Bytyqi

Pjesëmarrës të tjerë: Përfaqësues të MKRS –së OSBE-së, KDI- së dhe mediat.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli

Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky:

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të dt.13.10.2015, dhe 14.10.2015;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Kinematografinë;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbaleve të dt.13.10.2015, dhe 14.10.2015.

Procesverbalet nga mbledhjet e kaluara u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Kinematografinë;

Komisioni, vazhdoi me shqyrtimin nen për nen të Projektligjit, njëkohësisht duke shqyrtuar dhe analizuar vërejtjet dhe sugjerimet e propozuara me shkrim nga grupet e interesit dhe komuniteti artistik.

Anëtarët e Komisionit filluan me shqyrtimin nga neni 7 i projektligjit, me këtë rast u propozuan disa amendamente të cilat priten të rishshqyrtohen dhe riformulohen në mbledhjen e radhës.

4. Të ndryshme

Anëtarët e Komisionit vazhduan me shqyrtimin e nenit 29 të Projektligjit për Provimin e Maturës Shtetërore dhe u pajtuan që neni 29 të riformulohet si vijon:

Amendamenti 29

Neni 29

Sanksionet

1. Kryetari, anëtari, administruesi, mbikëqyrësi dhe vëzhguesi i testit të maturës i cili nuk i përfillë rregullat e administrimit të testit, konsiderohet si shkelje e lehtë, dhe dënohet për kundërvajtje në shumë prej treqind euro (300) € deri në pesëqind euro (500) €.
2. Kryetari, anëtari, administruesi, mbikëqyrësi dhe vëzhguesi i testit të maturës, i cili zbulon ndonjë sekret të testit që konsiderohet si shkelje e rëndë e testit të maturës dënohet me gjobë në të holla prej njëmijë (1000) deri në tremijë (3000) € si dhe me masa disiplinore dhe penale të parapara në Kodin Penal të Kosovës.
3. Kandidatët të cilët gjatë provimit të maturës shtetërore shkelin rregullat e mirësjelljes, të përcaktuara me udhëzues përkatës për provim, ju anulohet testi i maturës dhe të njëjtët i nënshtrohen provimit në afatet vijuese.

Komisioni u pajtua që amendamentet e propozuara lidhur me Projektligjin për Provimin e Maturës Shtetërore të procedohen për vlerësim në Komisionet e Përhershme.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani